



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2023/ 7 prot.

Datë 26.10.2022

**V E N D I M**  
**Nr. 1042/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.10.2022 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “AA&P” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-39183-08-18-2022 me objekt “Blerje materiale për mirëmbajtjen e objekteve publike (shkolla, zyra, varreza etj)”, me fond limit 7,716,599.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.08.2022 nga autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër
- Ankimues:** “Muca” SHPK  
*Autostrada Tiranë-Durrës, km.13, Picar, Vorë*
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Mallakastër  
*Lagjia “18 Prilli”, Ballsh, Mallakastër*
- Subjekti i Interesuar:** Operatori ekonomik “AA&P” SHPK  
*Njesia Bashkiake nr.6, Rruga "Tanush Frasheri", Mbrapa Shkolles "Musine Kokalari", Pallati "B&K" konstruksion, Tirane*
- ëBaza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për

*organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

### **Vëren:**

#### **I**

##### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

#### **II**

##### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 19.08.2022, është publikuar në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, SPE, procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-39183-08-18-2022 me objekt “Blerje materiale për mirëmbajtjen e objekteve publike (shkolla, zyra, varreza etj)”, me fond limit 7,716,599.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.08.2022 nga autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër.

II.2. Në datën 30.08.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik ankimues të dorëzuar pranë Komisionit të

Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 07.09.2022 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- “Murati D” shpk	6,151,550	lekë	skualifikuar
- “AA&P” SHPK	6,407,000	lekë	kualifikuar
- “Murati” SHPK	6,630,800	lekë	skualifikuar
- “Muca” SHPK	6,726,500	lekë	kualifikuar
- Vëllezërit Kuka	6,890,600	lekë	skualifikuar
- “Ardit-6” SHPK	6,895,000	lekë	kualifikuar
- “Zeqiri” SHPK	7,190,000	lekë	kualifikuar
- “Arteo 2018” SHPK	7,495,900	lekë	kualifikuar
- “Adenis Kastrati” p.f	7,705,100	lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 15.09.2022 është publikuar njoftimi i fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike.

II.5. Në datën 20.09.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është depozituar ankesa me nr. 2023 prot., e operatorit ekonomik “Muca” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “AA&P” SHPK. Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për operatorin ekonomik “AA&P” SHPK si më poshtë vijon:

*OE-AA&P duhet të dorëzonte pranë AK përveç dokumentacionit të dorëzuar në SPE dhe dokumentat e mëposhtme në origjinal ose të njesuara me origjinalin:*

*A- Në përputhje me piken A të Pjesës II-shkaqet e perjashtimit:*

- 1- Ekstraktin e thjeshte dhe historik te regjistrir tregtar- paragrafi i parë dhe paragrafi i peste.*
- 2- Vertetim nga gjykata per ceshtjet penale per subjektin, administratorin, ortaket dhe aksioneret - paragrafi i dyte.*
- 3- Vertetim nga prokuroria per ceshtjet penale per subjektin, administratorin dhe ortaket dhe aksioneret paragrafi i dyte dhe i trete.*
- 4- Vertetim i gjendjes gjyqesore per subjektin nga DPB ose e -albania.*
- 5- Vertetim i gjendjes gjyqesore per administratorin, ortaket dhe aksioneret, nga e-albania.*
- 6- Vertetim nga gjykata per ceshtjet civile per subjektin-paragrafi i katert.*
- 7- Vertetim nga tatimet per pagesen e tatimeve dhe sigurimeve - paragrafi i gjashte.*
- 8- Vertetim per detyrimet e energjise elektrike (pershire muajin korrik), nga FSHU - paragrafi i shtate.*

*B- Ne përputhje me pikën B të Pjesës IIIV — Kriteret e kualifikimit:*

*9- Vertetim për numrin e punonjësve të deklaruar (nqs ka deklaruar që disponon punonjës)*

*10- Dokumentacionin e mjeteve të deklaruar (nqs ka deklaruar që disponon mjete)*

*OE AA&P nuk ka dorëzuar dokumentat e mesiperpermendura, dhe rrjellimisht në bazë të Ligjit, duhet të ishte skualifikuar nga ana e AK.*

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 2023/2, datë 21.09.2022 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Muca” SHPK.

II.7. Në përputhje me parashikimet e nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, me shkresën e datës 26.09.2022 protokolluar me tonën nr. 2023/3 prot., datë 28.09.2022 pranë Komisionit Prokurimit Publik janë paraqitur argumente nga operatori ekonomik i interesuar “AA&P” SHPK, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.8. Me shkresën nr.4621/6 prot. datë 03.10.2022, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 2023/4 prot., datë 05.10.2022 me lëndë “Komunikim akti “Vendimmarje e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës”, autoriteti kontraktor njofton se nuk e ka pranuar ankesën e operatorit ekonomik “Muca” SHPK.

II.9. Me shkresën nr. 4869/1 prot., datë 06.10.2022 protokolluar me tonën nr. 2023/6 prot., datë 10.10.2022 me objekt “Informacion mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Muca” SHPK në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale për mirëmbajtjen e objekteve publike (shkolla, zyra, varreza etj)”, me nr. reference REF-39183-08-18-2022” autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP një informacion më të detajuar për trajtimin e ankesës duke i bashkëngjitur shkresës edhe dokumentacionin përkatës.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit paraprak të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Muca” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “AA&P” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi me arsyetimin se operatori ekonomik “AA&P” SHPK duhet të dorëzonte pranë AK përveç dokumentacionit të dorëzuar në SPE dhe dokumentat e mëposhtme në origjinal ose të njësuara

me origjinalin: “Vërtetim i gjendjes gjyqësore për subjektin; Vërtetim i gjendjes gjyqësore për administratorin, ortakët dhe aksionerët” OE AA&P nuk ka dorezuar dokumentat e mesiperpermendura, dhe rrjellimisht në bazë të Ligjit, duhet të ishte skualifikuar nga ana e AK., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit ” autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

**Shtojca 7**

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituruar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

III.1.2. Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

### **Shtojca 8.**

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

### **FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I, Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### **A. Pjesa I:**

#### **Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

<b>Identifikimi</b>	<b>Përgjigjja</b>
---------------------	-------------------

Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

## B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik

(nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	N IPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të

**mbështetet operatori ekonomik**

<b>Emri (at) e subjekteve</b>	<b>NI PT-i</b>	<b>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</b>	<b>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</b>

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit****A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

<b>Deklarata</b>	<b>Referencat (kur janë të zbatueshme)</b>
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:  Adresën e ueb-it: [shkruajeni]  Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]  Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:  Adresën e ueb-it: [shkruajeni]



<p>dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>	<p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p>

	<p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.	
---	--

## **B: DEKLARATA**

### **Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**

<b>Deklarata</b>	<b>Përgjigje</b>
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	_____
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;	<b>Po [ ]</b>
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	<b>Po [ ]</b>
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	<b>Po [ ]</b>
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;	<b>Po [ ]</b>

<p>5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:</p> <p>a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti Kontraktor;</p> <p>b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .</p>	<p><b>Po [ ]</b></p>
<p>6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;</p>	<p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p>
<p>7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).</p>	<p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p>
<p>8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :</p> <p>a) çmimet;</p> <p>b) metodat, faktorët ose formulat e</p>	<p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p>

<p>përdorura për llogaritjen e çmimit;</p> <p>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose</p> <p>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.</p>	
<p>9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.</p>	<p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p>
<p>10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.</p>	<p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p>

--

## **C: DEKLARATA**

### **Mbi Konfliktin e Interesit**

<p><b>Deklarata</b></p>
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:</p> <p>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p> <p>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe</p>

institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit të Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005.

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2022 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

## D: DEKLARATA

### Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:	
1. Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e së drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë e diskriminimit parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.	Po [ ] Jo [ ]
2. Operatori ekonomik ka kontratat përkatëse të punës me punonjësit e tij dhe garanton masa sigurie dhe shëndetësore për të gjithë dhe, në veçanti, për grupet në nevojë, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.	Po [ ] Jo [ ]
3. Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.	Po [ ] Jo [ ]

### Pjesa IIIV: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

#### A: DEKLARATË

#### Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e	Po [ ] Jo [ ]

lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	
---	--

--

## B: DEKLARATË

### Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

<b>Deklarata</b>	<b>Përgjigje</b>
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>	<p>Punonjës</p> <p>Po [ ] Jo [ ]</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve</p> <p>Profili i punonjësve</p> <p>Makineri e mjete</p> <p>Po [ ] Jo [ ]</p> <p>Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete:</p>
<p>Data e dorëzimit të deklaratës _____ Vula _____</p> <p>Emri, Mbiemri, Firma _____</p>	

### Ju lutemi sigurohuni që:

**-Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.**

- Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, **një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit** duhet të paraqitet edhe nga subjekti



mbështetës.

- Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

*Shenim: Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik "AA&P" SHPK në përmbushje të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku në Pjesën II "Shkaqet e përjashtimit", Pika A "Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit" seksioni i dytë është përcaktuar: "Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së" ndërsa në seksionin e tretë është përcaktuar: "Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

1. Gezim Bendaj Adminsitrator
2. Dshnor Hajderaj Ortaku
3. Zihni Halimi Ortaku

*nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së etj."*

III.1.5. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" përcaktohet se: "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të

përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.6. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.7. Në nenin 25 “Kriteret e Përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet se: “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së, janë të detyrueshme për t'u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Këto kritere synojnë sigurimin e ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës.”

III.1.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “**Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

**6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.1.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, nëpërmjet kritereve të përgjithshme për kualifikim *synohet sigurimi i ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës*. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.* 2. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.* Referuar dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi *kriteret e përgjithshme për kualifikimi duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8*. Nga verifikimi i dokumentacionit operatori ekonomik “AA&P” SHPK ka dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8) ku në Deklaratën A, seksioni i treta ka përcaktuar “*Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:*

1. *Gezim Bendaj Admistrator*
2. *Dashnor Hajderaj Ortaku*
3. *Zihni Halimi Ortaku*

*nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së etj.”*

Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimes se operatori ekonomik “AA&P” SHPK duhet të dorëzonte pranë autoritetit kontraktor përveç dokumentacionit të dorëzuar në SPE dhe dokumentat e mëposhtme në origjinal ose të njësuara me origjinalin: “*Vërtetim i gjendjes*

*gjqësore për subjektin; Vërtetim i gjendjes gjyqësore për administratorin, ortakët dhe aksionerët”. OE AA&P nuk ka dorëzuar dokumentat e mesiperpermendura, dhe rrjellimisht ne baze të Ligjit, duhet të ishte skualifikuar nga ana e AK.”, KPP nga verifikimi i dokumentacionit pjesë e fashikullit të shqyrtimit administrative vëren se pas kërkesës së autoritetit kontraktor drejtuar operatorit ekonomik “AA&P” SHPK si operatori ekonomik i kualifikuar i pari me datë 07.09.2022 në sistemin e prokurimit elektronik, me qëllim dorëzimin e dokumentacionit provues të deklaruar dhe ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik, operatorit ekonomik “AA&P” SHPK me datë 12.09.2022 ka dorëzuar në autoritetin kontraktor Bashkia Mallakastër dokumentacionin provues të deklaruar si dhe atë të ngarkuar në rrugë elektronike. Nga verifikimi i dokumentacioni të dërguar në autoritet kontraktor me datë 12.09.2022 vihet re se ndër të tjera nuk është paraqitur dokumentacioni cili vërteton gjendjen gjyqësore të ortakëve z. Dashnor Hajderaj dhe z. Zihni Halimi të cilët vetë operatori ekonomik ankimes në formularin përmbledhës të vetë deklarimit i ka paraqitur në këtë cilësi. Ky informacioni mbi gjendjen e tyre gjyqësore (dëshmia e penaltetit) në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik është dorëzuar në autoritet kontraktor vetëm me datë 26.09.2022 protokolluar me nr. 4621/4 prot., dhe nga ku rezulton se data e lëshimit të dokumentit mbi vërtetimin e gjendjes gjyqësore për ortakët e shoqërisë z. Dashnor Hajderaj dhe z. Zihni Halimi është respektivisht 21.09.2022 dhe 22.09.2022, pra pasi është dorëzuar dokumentacioni provues në autoritet kontraktor me datë 12.09.2022 nga operatori ekonomik “AA&P” SHPK si dhe pasi autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit me datë 15.09.2022 mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “AA&P” SHPK. Gjithashtu referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, KPP vëren se edhe vërtetimi i gjendjes gjyqësore të subjektit “AA&P” SHPK në përmbushjen të përcaktimeve të pjesës II, Deklarata A, seksioni i dytë, të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nuk është paraqitur në momentin e dorëzimit të dokumentacioni në autoritet kontraktor me datë 12.09.2022 por ky dokument është dorëzuar në autoritet kontraktor vetëm me datë 26.09.2022 protokolluar me shkresën nr. 4621/4 prot. Nga verifikimi i dokumentit mbi vërtetimin e gjendjes gjyqësore të subjektit “AA&P” SHPK rezulton se ai është lëshuar me datë 16.09.2022 nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve pra, pasi është dorëzuar dokumentacioni provues në autoritet kontraktor me datë 12.09.2022 nga operatori ekonomik “AA&P” SHPK si dhe pasi autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit me datë 15.09.2022. Akoma më tej KPP vëren se vetë operatori ekonomik ekonomik “AA&P” SHPK ka pranuar që: “[...]Pas shpalljes fitues subjekti jonë ka dorëzuar me datë 12.09.2022 pranë AK të gjithë dokumentacionin i paraqitur dhe në rrugë elektronike. Nga ana e subjektit tonë është paraqitur pranë AK vërtetim i gjendjes gjyqësore i administratorit t shoqërisë Gëzim Bendaj nr. 10.09.2022 ndërsa dokumentacioni tjetër provues mbi gjendjen gjyqësore të shoqërisë si dhe të ortakëve është bërë aplikimi në momentin e njoftimi paraprak të operatorit fitues pranaë institucioneve përkatëse që lëshojnë këto dokumente të cilat nuk na janë vënë në dispozicion brenda afatit 5 ditorë të paraqitjes së dokumentacionit provues [...]”*

III.1.10. Referuar sa më sipër KPP, gjykon se autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim me parashikimet ligjore të nenit 26 pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pasi ka kryer publikimit e njoftimit të fituesit dhe rrjedhimisht nisjen e afateve të ankimit për një operator ekonomik i cili rezulton me mangësi në dokumentacionin provues të depozituar në autoritet

kontraktor në raport me atë që është përcaktuar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit ku ky i fundit shërben si provë paraprake vetëm në momentin e hapjes dhe vlerësimit të ofertave. Komisioni në arsyetimin e tij shkon akoma më tej duke gjykuar, se ka dy mënyra se si autoriteti kontraktor mund të marrë dokumentet e përcaktuara në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, e para në bazë të të dhënave të aksesueshme shtetërore nëse është i disponueshëm dhe e dyta *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronik.* Në rastin konkret ndodhemi përpara mënyrës së dytë dhe në momentin procedural në të cilin ndodhej procedura e prokurimit pra pasi është kryer njoftimit i vlerësimit/klasifikimit, për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit të deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit autoriteti kontraktor duhet ti referohej dokumenteve provues të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues pranë autoritetit kontraktor me datë 12.09.2022 të cilat duhet të jenë në përputhje të plotë me dokumentet e ngarkuara në sistem elektronik si dhe me deklaratat e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit me qëllim që autoriteti kontraktor pas verifikimit të prezencës së dokumentacionit të dorëzuar dhe përputhshmërisë së plotë të tij me atë që është ngarkuar në sistemin elektronik si dhe është deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të vijonte me hapat e mëtejshëm të njoftimit të fituesit dhe rrjedhimisht nisjes së afateve të ankimit. Në rastin konkret nga gjithë analiza e provave dhe e fakteve dhe verifikimi i tyre rezulton se autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit për një operator ekonomik i cili është kualifikuar i pari por që përpara publikimit të njoftimit të fituesit nuk ka dorëzuar dokumentacionin provues në autoritet kontraktor në përmbushje të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit e konkretisht për vërtetimin e gjendjes gjyqësore për dy ortakët e shoqërisë si dhe vërtetimin mbi gjendjen gjyqësore të vetë subjektit prandaj autoriteti kontraktor në përmbushje të detyrimeve ligjore duhet të marrë masa për korigjimin e shkeljeve duke e skualifikuar operatorin ekonomik “AA&P” SHPK.

Sa më lart pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Muca” SHPK qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Muca” SHPK mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “AA&P” SHPK referuar parimit të ekonomisë në procesin administrativ ato nuk do të merren në shqyrtim për sa kohë gjendja juridike dhe faktike e operatorit ekonomik “AA&P” SHPK pas arsyetimit të mësipërm të KPP-së do të ndryshojë duke u skualifikuar e rrjedhimisht duke përmbushur edhe interesin e ankimuesit.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin

*e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,*

**Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Muca” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-39183-08-18-2022 me objekt “Blerje materiale për mirëmbajtjen e objekteve publike (shkolla, zyra, varreza etj)”, me fond limit 7,716,599.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.08.2022 nga autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër.
  2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “AA&P” SHPK duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
  3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vëre në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
  4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Muca” SHPK.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**